



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 188

Tiranë – E mërkurë, 15 tetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 9.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2024..... 22831
Rezolutë e Kuvendit datë 9.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2024.... 22832
Rezolutë e Kuvendit datë 9.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2024..... 22834
Rezolutë e Kuvendit datë 9.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2024..... 22836
Urdhër i ministrit të Financave nr. 131, datë 10.10.2025	Për delegimin e kompetencave..... 22837
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 133, datë 26.9.2025	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve në këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare strategjike dhe jostrategjike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” 22837
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 173, datë 14.10.2025	Për delegimin e kompetencave..... 22838
Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 520, datë 9.10.2025	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinët” 22839
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 206, datë 9.9.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV..... 22840
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 9.9.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Amel Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw..... 22841

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 208, datë 9.9.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Green Value” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	22843
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 209, datë 9.9.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Green Value” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	22844
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 9.9.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k.....	22845
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 9.9.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 160, datë 18.7.2025, “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.....	22846
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 9.9.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 8.7.2025, “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘SunPro’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”	22848
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 214, datë 18.9.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	22849
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 215, datë 18.9.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Spitalla Solar” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	22851
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 216, datë 18.9.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k.....	22852
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 255, datë 15.10.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw.....	22854
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 238/17, datë 13.10.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtim rruga ‘Kthesa e Bërdicës–Ura e Baçallëkut”	22857
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 847/10, datë 10.10.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërhyrje në zona sportive dhe lodra për fëmijë, ‘Dua të Luaj’, Bashkia Fier”.....	22861
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 283/20, datë 10.10.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Zgjerimi i superstradës Tiranë–Durrës (loti 1) – faza I & faza II”.....	22862

REZOLUTË**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË PËR VITIN 2024****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke vlerësuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, i cili vijon të ketë një rënie nga viti në vit; humbjet e energjisë elektrike për vitin 2024 arritën në nivelin 17.93%, duke shënuar një ulje të mëtejshme krahasuar me vitin 2023 (18.93%), ndërkohë niveli total i arkëtimeve për vitin 2024 arriti shifrat 100.5% duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2023 (99.4%);

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishme sigurinë kibernetike për operatorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror në vend;

Vlerëson për vitin 2024:

Punën dhe kontributin e ERE-s për plotësimin e kuadrit rregullator, lidhur me operimin e ALPEX-it, rritjen e numrit të anëtarëve të rinj të Bursës dhe vëllimit të tregtuar të energjisë, duke bërë të mundur një objektiv të rëndësishëm: atë të krijimit të tregut të përbashkët energjetik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Bashkëpunimin e ERE-s me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për Skemën e Faturimit Neto dhe Rregullat për Vetëprodhuesit e Energjisë, si një dokument i rëndësishëm në përcaktimin e rregullave dhe procedurave për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme.

Bashkëpunimin e ERE-s me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), si dhe punën e bërë nga ERE-ja për rishikimin e Rregullores për Sigurinë Kibernetike, duke zgjeruar përgjegjësitë për operatorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Punën e bërë nga ERE-ja dhe propozimet konkrete për rishikimin e ligjit për sektorin e energjisë elektrike, të cilat kanë si qëllim përshtatjen e tij me zhvillimet e reja në tregun e energjisë dhe

përmbushjen e detyrimeve të vendit, në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të rregullatorit, vlerëson pjesëmarrjen e stafit të ERE-s në trajnime të ndryshme të Shkollës Ballkanike të Energjisë, si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira në fushën e rregullimit të tregjeve të energjisë.

Nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstitucional me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, përmes së cilës janë adresuar disa çështje kyçe, si: përmirësimi i kuadrit rregullator për eficiencën e energjisë, shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit për përdorimin e energjisë dhe masat për rritjen e eficiencës, rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e eficiencës energjetike etj.

Bashkëpunimin e ERE-s me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, në kuadër të projektit TAP Ag, si dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Autoritetin Rregullator për Energinë, Mbetje dhe Ujë të Greqisë si një hap i rëndësishëm për thellimin e bashkëpunimit dypalësh dhe krijimin e një kuadri të strukturuar për shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave në fushën e rregullimit të tregut të energjisë.

Kontributin e dhënë dhe punën e bërë nga ERE-ja si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2020–2030.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2025 rekomandon:

1. Të mundësojë implementimin e një platforme digjitale për trajtimin e ankesave dhe gjurmimin e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve, duke e bërë më të thjeshtë verifikimin *online* të statusit të ankesës dhe më të aksesueshme (*user friendly*) për konsumatorët, si dhe në mënyrë të vazhdueshme të ketë prioritet të punës së tij trajtimin me përgjegjësi të ankesave si një instrument i drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe për përmirësimin e shërbimeve të operatorëve të energjisë.

2. Të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe palët e tjera të interesit për të adresuar sfidat që lidhen me promovimin dhe integrimin e projekteve për impiantet e prodhimit të energjisë elektrike për vetëprodhuesit. Rritja e prodhimit të energjisë nga impiantet fotovoltaike përmirëson sigurinë energjetike të vendit, duke diversifikuar burimet e energjisë dhe duke e bërë



sistemin më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve klimatike.

3. Me miratimin e rregullores së rishikuar, ndryshimet e së cilës synojnë rritjen e nivelit të mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në furnizimin e pandërprerë të energjisë dhe gazit natyror, ERE-ja të kërkojë me rigorozitet nga operatorët e përfshirë hartimin dhe zbatimin e planeve përkatëse për sigurinë kibernetike.

4. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të transparencës së rregullatorit, të marrë masa për publikimin e të gjitha vendimeve të bordit në faqen zyrtare *online*, si dhe t'i kushtojë vëmendje të shtuar përditësimit të informacionit në faqen zyrtare të Entit.

5. Të vijojë të tregojë vëmendje të shtuar gjatë procesit të shqyrtimit të planeve të investimeve të OSSH-së dhe OST-së, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me objektivat e politikave energjetike kombëtare, si dhe të rishikojë periodikisht planifikimin afatgjatë të investimeve për të adresuar zhvillimet e reja dhe nevojat e konsumatorëve me fokus të veçantë zonat turistike.

6. Pas miratimit të akteve përkatëse për vendosjen e detyrimit të përdorimit të Platformës së Krahimit të Çmimeve (PCT) në tregun e lirë, një hap i rëndësishëm, i cili synon të sigurojë transparencë dhe konkurrencë në treg, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve, ERE të zhvillojë fushata promovuese për modalitetet e funksionimit të kësaj platforme.

7. Të vijojë monitorimin e Bursës ALPEX dhe kontributin e tij si rregullator për funksionimin e një tregu transparent, i bazuar në bursën ALPEX, i cili nxit investimet në Energjinë e Rinovueshme, rrit konkurrencën e ndershme, si dhe rrit mundësinë që Shqipëria të integrohet në platforma evropiane të tregtimit të energjisë.

8. Në vijim të akteve që duhen miratuar si detyrim i ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE të marrë masat për miratimin e "Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë të ditës në avancë", metodologji e cila synon të vlerësojë kapacitetin dhe fleksibilitetin e tregut shqiptar për të operuar në përputhje me praktikatat më të mira të tregut të lirë të energjisë, duke siguruar kushte të favorshme për pjesëmarrjen e

aktorëve të ndryshëm dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemin energjetik.

9. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, krahas adresimit të çështjeve të rëndësishme, si: përmirësimi i kuadrit rregullator për eficiencën e energjisë, rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e eficiencës energjetike, etj., të ketë në vëmendje edhe hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme për adresimin e çështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit eficient të energjisë.

10. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë për konsumatorët, të marrë masa për rishikimin e rregullave dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët e rrjetit.

11. Të marrë masa për përgatitjen e standardeve të lëshimit të certifikatave të garancisë së origjinës, në përputhje me standardet e Sistemit Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS), si dhe të vijojë adresimin e çështjeve me të cilat ballafaqohen konsumatorët e energjisë dhe pjesëmarrësit e tregut në tërësi, të cilat kërkojnë ndërhyrjen e rregullatorit.

12. Pas miratimit të metodologjisë përkatëse nga Këshilli i Ministrave të marrë masat e nevojshme për miratimin në kohë të çmimit të energjisë elektrike të gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme.

Miratuar në datën 9.10.2025.

KRYETAR
Niko Peleshi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke theksuar faktin se reforma në sektorin UK ka dhënë impaktin e vet pozitiv në drejtim të përmirësimit në përgjithësi të situatës financiare të sektorit UK, duke sjellë një përmirësim të treguesve



kryesorë të performancës si: “Uji pa të ardhura”, “Mbulimi i kostove O&M”, “Niveli i Matjes”, “Eficiencën e stafit”, “Kohëzgjatja e furnizimit me ujë” etj.;

Duke theksuar faktin se sfidat e sektorit UK, si dhe reforma e ndërmarrë nga qeveria në këtë sektor e bëjnë të domosdoshëm miratimin sa më parë të ligjit të ri, duke i dhënë ERRU-së kompetencat e nevojshme të rregullatorit të sektorit, si dhe duke rritur pavarësinë e tij institucionale;

Vlerëson për vitin 2024:

Faktin që pas rekomandimeve të përsëritura, në dy shoqëri rajonale UKR Fier dhe UKR Durrës ka filluar puna për realizimin e sistemeve të monitorimit me kamera 24/7 dhe ndërtimi i sallave të monitorimit të objekteve të rëndësishme të veçantë të sistemeve të FU-së dhe KUN-së duke bërë të mundur uljen e kostove të stafit dhe ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e treguesve të performancës;

Faktin që për herë të parë gjatë 9 vjetëve të fundit treguesi “Uji pa të ardhura” bie në nivelin 61%, ndërkohë që për 8 vjet me radhë 63–67% e ujit që prodhohej mbetej pa të ardhura;

Si arritje të rëndësishme digjitalizimin e të gjithë sistemit financiar dhe të faturimit të shoqërive UK, si një kontribut i drejtpërdrejt në operimin normal të tyre, si dhe në krijimin e kushteve për mbledhjen dhe raportim të të dhënave të besueshme nga shoqëritë UK, i cili u mundëson rregullatorit dhe vetë shoqërive një vlerësim real të TKP-ve, si dhe vendosjen e objektivave racionalë;

Bashkëpunimin mes ERRU-së dhe AKUK-së në përmbylljen e draftit final të dokumentit “Për hartimin dhe miratimin e modelit të planeve 5-vjeçare të biznesit për shërbimet e UK-së”, dokument i cili do të jetë një udhëzues shumë i mirë sidomos për shoqëritë UK, të cilat mbulojnë mbi 100% kostot O&M dhe tentojnë të mbulojnë kostot totale;

Punën e bërë nga ERRU-ja në trajtimin e ankesave të konsumatorëve, me gjithë kufizimin ligjor, si dhe zgjidhjen e ankesave nëpërmjet strukturës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM);

Punën e bërë nga ERRU-ja dhe asistencën e ofruar për shoqëritë UK rajonale për plotësimin e plotë dhe të saktë të dokumentacionit të kërkuar, në mënyrë që të përmbyllnin me sukses aplikimin e tyre për nivel të ri tarifor, duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK;

Punën e bërë nga ERRU-ja në përmbushje të kërkesave të *acquis*, në lidhje me direktivat europiane për ujin e pijshëm, ujërat e ndotura dhe të llumrave të ITUN-së.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2025 rekomandon:

1. Të luajë një rol kryesor dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët që operojnë në sektorin e ujit për të bërë të mundur realizimin e objektivave strategjikë sektorialë, si dhe për krijimin e një mjedisi që siguron stabilitet për shoqëritë UK dhe shërbim më të mirë për konsumatorët.

2. Të nxisë dhe të promovojë më tej, në bashkëpunim me AKUK-në, vendosjen e sistemeve të monitorimit me kamera dhe atyre me mbrojtje perimetrale inteligjente, të cilat realizojnë një mbrojtje më efikase të sigurisë së objekteve të rëndësishme të veçantë të sistemeve të FU-së dhe KUN-së dhe ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e kostove të stafit dhe përmirësimin e treguesve të performancës. Iniciativa e dy shoqërive rajonale Fier dhe Durrës në implementimin e sistemeve të monitorimit me kamera duhet të promovohet edhe për shoqëritë e tjera.

3. Të bashkëpunojë ngushtë me AKUK-në për të bërë të mundur që brenda vitit 2025 Sistemi i Integruar i Informacionit të Performancës (IPIS) të jetë funksional dhe në përdorim. Saktësia dhe unifikimi i të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK është shumë i rëndësishëm dhe shërben si një bazë e fortë për planifikimin e politikave të zhvillimit të këtij sektori në funksion të qytetarëve.

4. Pas aplikimit të 6 shoqërive rajonale për nivel të ri tarifor, të vijojë të asistojë shoqëritë e tjera rajonale për problematikat që në mjaft raste priten të hasen nga propozimet e tarifave të reja, duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK.

5. Krijimi dhe organizimi i shoqërive rajonale ujësjellës-kanalizime paraqet sfida të reja në drejtim të organizimit për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, ndaj ERRU-ja duhet të intensifikojë punën e monitorimit në terren të ankesave të konsumatorëve, veçanërisht të ankesave me natyrë teknike, që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm.

6. Të marrë masat që faqja e ERRU-së në internet apo edhe faqet e ERRU-së në rrjetet sociale të kenë në fokus konsumatorin dhe ndërgjegjësimin e tij për rolin ndërveprues që ka në marrëdhënie me ofruesit e shërbimit. Linku ku konsumatorët mund



të paraqesin ankesë në ERRU, si dhe informacioni përkatës për të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit duhet të kenë një vend kryesor.

7. ERRU, nga njëra anë, para vendosjes së objektivave përkatës për Treguesit Kryesorë të Performancës për shoqëritë UK rajonale, të kryejë një analizë të detajuar tekniko-ekonomike bazuar në mundësitë reale që ka çdo shoqëri UK dhe nga ana tjetër të ndjekë me rigozitet zbatimin e këtyre objektivave të vënë dhe, në rast se këta objektiva nuk arrihen, të mos miratojë rritje tarifash kur këto shoqëri të aplikojnë sërish.

8. Me gjithë trendin e ngadaltë pozitiv, shoqëritë rajonale UK duhet të vijnë përmirësimin e treguesit “Uji pa të ardhura”, duke kryer investime për instalimin e matësve në burim, për një përcaktim më të saktë të sasisë së ujit të prodhuar, plotësimi 100% i klientëve me matës individualë, si dhe rritjen e faturimit. Reduktimi i “Uji pa të ardhura” ndikon direkt në kohëzgjatjen e furnizimit me ujë, uljen e kostove dhe rritjen e eficiencës për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë për konsumatorët.

9. Është e domosdoshme që në Shoqëritë Rajonale UK të kryhet një auditim i detajuar për eficiencën e energjisë, identifikimin e plotë të situatës aktuale të konsumit të energjisë të pajisjeve, makinerive të ndryshme, motorëve dhe linjave, duke paraqitur mundësitë e ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të ndryshme për uljen e konsumit të energjisë duke u fokusuar në përdorimin e burimeve alternative të rinovueshme.

10. ERRU të vendosë objektiva agresivë në drejtim të rritjes së nivelit të matjes për shoqëritë që aplikojnë për nivel të ri tarifar dhe të monitorojë përmbushjen e objektivave nga shoqëritë rajonale pasi përmbushja e tyre ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit të ofruar për konsumatorët, si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë, duke ndikuar në përmirësimin e tyre.

11. ERRU-ja, në kuadër të hapjes së negociatave me BE-në, të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të *acquis communautaire* të Shqipërisë në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN-së.

Miratuar në datën 9.10.2025.

KRYETAR
Niko Peleshi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm miratimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të ligjit të ri nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili krahas përafrimit të mëtejshëm me direktivën (EU) 2018/1972 dhe arritjen e objektivit strategjik për një shoqëri gigabit, bën të mundur edhe rritjen e pavarësisë financiare dhe funksionale të AKEP-it;

Duke theksuar rëndësinë e sigurimit të një kuadri rregullator të favorshëm për hyrjen e MVNO-ve në treg, bazuar në praktikat më të mira evropiane;

Vlerëson për vitin 2024:

Punën e bërë nga AKEP-i për realizimin e analizës së tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, e cila duhej të ishte realizuar më parë konform kërkesave ligjore. Gjithashtu, vlerëson masat rregulluese të përcaktuara për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në këtë treg, si dhe trajtimin në analizë të mundësisë së futjes së operatorëve të rrjetit virtual mobile (MVNO) në tregun e shërbimeve celulare si një faktor i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të konkurrencës në tregun e telefonisë mobile.

Punën e bërë nga AKEP-i për përfundimin me sukses të tenderit publik për dhënie të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400–3800 MHz si një zhvillim me rëndësi në implementimin e rrjeteve të gjeneratës së pestë celulare (5G), të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

Punën e bërë për ngritjen e grupit të punës “Për kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse të situatës së sigurisë kibernetike në infrastrukturën e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”, i cili do të bëjë një vlerësim të të gjitha aspekteve që



lidhen me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare.

Punën e bërë për hartimin e ndryshimeve në rregulloren “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”. Miratimi i këtij dokumenti do të shmangë arbitraritetin dhe subjektivitetin në vendosjen e gjobave dhe do të sigurojë që inspektorët dhe subjektet e kontrolluara të kenë pritshmëri të qarta mbi sanksionet e mundshme.

Bashkëpunimin e AKEP-it me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) si në aspektin parandalues, ashtu edhe në aspektin e mitigimit të incidenteve kibernetike.

Studimin e AKEP-it, lidhur me kuadrin ligjor, rregullator, teknik dhe administrativ në fuqi për krijimin dhe hyrjen në treg të operatorëve virtualë të shërbimeve të lëvizshme (MVNO), si dhe faktin që për herë të parë në historinë e akordimit (dhënie në përdorim) të frekuencave (3400 MHz– 3800 MHz) në vendin tonë, AKEP-i ka vendosur detyrimin e fituesve të tenderit t’u japin akses MVNO-ve.

Kuvendi për vitin 2025, rekomandon:

1. Pas përfundimit të analizës së tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, të marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e masave rregulluese të përcaktuara për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në këtë treg, si dhe problematikave të tjera të dala nga kjo analizë.

2. Të marrë masa për realizimin e analizës së tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimin e ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal në këtë treg.

3. Të marrë masat e nevojshme për rishikimin e rregullores “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” bazuar edhe në përcaktimet e reja ligjore të ligjit nr. 54/2024, që lidhen me këtë proces, për të bërë të mundur përmirësimin e procesit të portimit, duke siguruar që të jetë një proces i thjeshtë, efektiv dhe që mbron të drejtat e përdoruesve fundorë.

4. Gjatë inspektimeve dhe auditeve të ndryshme që AKEP-i kryen, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve të sipërmarrësve, në lidhje me implementimin e akteve ligjore dhe rregullatore, që kanë të bëjnë me sigurinë, integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të sipërmarrësve të komunikimeve

elektronike, si dhe atyre që lidhen me mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

5. Të organizojë një këshillim publik, lidhur me implementimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 54/2024, i cili të përfshijë aktorë të ndryshëm, siç janë operatorët e shërbimeve, qytetarët, etj., për të siguruar një proces transparent dhe të drejtë lidhur me ndryshimet e pritshme.

6. Të vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë që të sigurohet implementimi i tij.

7. Pas miratimit të ligjit nr. 54/2024 dhe duke u bazuar në praktikat më të mira të BE-së, të marrë masa për implementimin në kohë të ndryshimeve rregullatore, që kanë të bëjnë me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

8. Pas rritjes së pritshme të kapaciteteve logjistike nga Posta Shqiptare sh.a., të monitorojë ecurinë e përmirësimit të shërbimit për përmbushjen e detyrimit të shpërndarjes së objekteve postare në adresën e marrësit.

9. Të konsiderojë nga viti 2025 e në vijim implementimin e metodologjisë së vendeve të BE-së për përcaktimin e tarifave të terminimit, duke qenë se ato kanë për qëllim orientimin e çmimeve drejt kostos së terminimit të thirrjeve.

10. Të rrisë përpjekjet për promovimin e investimeve në rrjetet e shpejtësisë së lartë, përfshirë 5G, dhe konkurrencën efektive në treg, duke pasur në vëmendje mbrojtjen e përdoruesve dhe sigurimin e shërbimit universal të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të ligjit të ri dhe përvojave në vendet e BE-së.

11. Të vijojë monitorimet e treguesve të cilësisë së shërbimit QoS (*Quality of service*) të telefonisë së lëvizshme në të gjitha zonat e Republikës së Shqipërisë, përfshi akset rrugore të vendit dhe zonat turistike, duke kërkuar nga dy operatorët në treg vendosjen e stacioneve provizore apo optimizimin e antenave ekzistuese në zonat ku mbulimi me sinjal nuk i përmbush parametrat KPI (*Key Performance Indicators* – Indikatorët Kyç të Performancës).

Miraturar në datën 9.10.2025.

KRYETAR
Niko Peleshi

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN 2024****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e veçantë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në qasjen për forcimin e kulturës së garantimit të standardeve më të larta në ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

Duke vlerësuar rolin aktiv të këtij institucioni në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, specifikisht për kontributin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

Duke vlerësuar veprimtarinë e institucionit në përmbylljen e procesit të përmirësimit të legjislacionit në fushën e të drejtës për informim;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e ngushtë dhe konstant me qytetarë apo grupe interesi, autoritete publike, subjekte juridike në sferën private, organizata të shoqërisë civile dhe medien;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2024 dhe vlerëson:

Marrjen e Presidencës së Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) duke rritur prestigjin e saj në nivel ndërkombëtar.

Kontributin e dhënë nga institucioni në hartimin dhe miratimin e ligjit të ri nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili është përafëruar plotësisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).

Zhvillimin e një sërë aktiviteteve të rëndësishme që lidhen me zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe forcimin e transparencës institucionale.

Monitorimin e autoriteteve publike, me qëllim vlerësimin e mënyrës se si ato zbatojnë detyrimet ligjore për publikimin e informacionit. Në këtë kuadër, janë regjistruar një numër i konsiderueshëm kërkesash për informacion publik, të cilat janë ndjekur përmes sistemit elektronik të raportimit.

Verifikimin e nivelit të transparencës proaktive në 251 institucione qendrore për të siguruar publikimin në kohë të informacionit të detyrueshëm.

Faqe | 22836

Trajtimin e ankesave nga qytetarë dhe organizata që kanë hasur vështirësi në marrjen e informacionit nga institucionet publike.

Bashkëpunimin e ngushtë me institucionet për përgatitjen e listave të dokumenteve të hapura dhe për trajnimin e personave të kontaktit, në lidhje me standardet e të dhënave të hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik.

Hartimin e akteve nënligjore si udhëzimi “Për licencën standarde për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe VKM-ja nr. 444/2024, që parashikon shtimin e kategorive tematike të informacionit të hapur.

Gjithashtu, ofrimin e mbështetjes praktike për autoritetet publike në zbatimin e ligjit nr. 33/2022, si dhe hartimin e një manuali udhëzues për organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike për të lehtësuar implementimin e këtij ligji në praktikë.

Kryerjen e hetimeve administrative në kuadër të funksioneve mbikëqyrëse, me synim garantimin e respektimit të të drejtës për informim dhe rritjen e llogaridhënies publike.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2025, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të angazhohet në mbylljen e boshllëqeve ekzistuese nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, për të siguruar që legjislacioni i ri të shoqërohet me instrumente të qarta zbatimi.

2. Të kryejë një plan trajnimesh, në kuadër të informimit për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), duke marrë parasysh që shumë institucione vazhdojnë të hasin vështirësi për të implementuar plotësisht SMSI-në.

3. Të përforcohet bashkëpunimi me institucionet arsimore, shëndetësore, bankare dhe teknologjike për të standardizuar praktikat dhe për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit në menaxhimin e të dhënave.

4. Të organizohen fushata edukative të specializuara për grupet më të prekshme dhe për administratën publike, duke synuar parandalimin sistematik të shkeljeve, promovimin dhe respektimin e privatësisë në çdo fazë të procesit administrativ.

Miraturar në datën 9.10.2025.

**KRYETAR
Niko Peleshi**



URDHËR
Nr. 131, datë 10.10.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Financave, zëvendësministrit të Financave, z. Andi Memeti, nga data 13.10.2025 deri në datën 17.10.2025.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Financave z. Andi Memeti për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 133, datë 26.9.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
PËR SHPALLJEN DHE PËRZGJEDHJEN
E ANËTARËVE NË KËSHILLAT
MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE
TREGTARE STRATEGJIKE DHE
JOSTRATEGJIKE TË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË”

Bazuar në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 3.10.2018, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës ‘Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027’, në

kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian ‘Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor’”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve në këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare strategjike dhe jostrategjike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR
SHPALLJEN DHE PËRZGJEDHJEN E
ANËTARËVE NË KËSHILLAT
MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE TREGTARE
STRATEGJIKE DHE JOSTRATEGJIKE
TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve në këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare në pronësi dhe administrim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 2
Parimet e përgjithshme

Përzgjedhja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës bëhet sipas një procedure të bazuar në parimin e mosdiskriminimit, meritës, transparencës dhe profesionalizmit.



Neni 3

Ndjekja e procesit

Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ndjek procesin e shpalljes dhe të kualifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

Neni 4

Publikimi i thirrjes

Me urdhër të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin/et vakante në Këshillin Mbikëqyrës.

Thirrja publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në rast të mungesës së konkurrencës apo moskualifikimit të asnjë prej kandidatëve, procedura e publikimit të thirrjes përsëritet.

Neni 5

Kriteret për përzgjedhjen e anëtarit të këshillit mbikëqyrës

Kandidati për anëtar në këshillin mbikëqyrës, paraqet pranë Ministrisë dokumentacionin si vijon:

- a) kopje të mjetit të identifikimit;
- b) jetëshkrimin;
- c) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike;
- ç) vërtetim që për të nuk është marrë masë disiplinore për largim nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- d) kopje të librezës së punës të njehsuar me origjinalin;
- dh) dëshmi penaliteti;
- e) vërtetim mjekësor që është i aftë për punë;
- ë) vetëdeklarim se nuk gjendet në konflikt interesi me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Procedura e verifikimit dhe e përzgjedhjes

Kandidatët përcjellin dokumentacionin zyrtarisht pranë Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, brenda një afati prej 5 (pesë) ditëve pune nga data e shpalljes së thirrjes.

Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, verifikon brenda 2 (dy) ditëve pune nga paraqitja e dokumentacionit, nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

Nëse struktura përgjegjëse për burimet njerëzore konstaton se dokumentacioni i paraqitur ka mangësi, e njofton kandidatin në rrugë elektronike për plotësimin e tyre brenda një afati prej 2 (dy) ditë pune.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, struktura përgjegjëse harton dhe përcjell pranë ministrit listën e kandidaturave dhe një relacion përmbledhës për secilin kandidat.

Ministri përzgjedh kandidatët fitues nga lista e paraqitur nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore.

Neni 7

Njoftimi i kandidatit fitues

Kandidatët fitues njoftohen me shkrim dhe shpallen në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

URDHËR**Nr. 173, datë 14.10.2025****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga data 14.10.2025 deri më datë 16.10.2025, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, z. Julian Hodaj.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Punëve të Brendshme, z. Julian Hodaj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana Koçiu

URDHËR
Nr. 520, datë 9.10.2025

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË
SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR JOPUBLIK,
KOPSHTI “KATËR STINËT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.9.2025, të ministrit të Arsimit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”, e subjektit juridik “4 Stinë” sh.p.k, i licencuar me urdhrin nr. 352, datë 3.12.2001, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, me kërkesën e tij datë 25.9.2025

2. Institucioni arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”, ka për detyrë:

a) Të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

b) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

c) Të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të arsimit parashkollor, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur nëse ka.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”.

b) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik.

c) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik kopshti “Katër Stinë”.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Tiranë të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”, të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 352, datë 3.12.2001, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Tiranë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor parauniversitar jopublik kopshti “Katër Stinë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani



VENDIM

Nr. 206, datë 9.9.2025

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2025, PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E
TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2396/1 prot., datë 4.9.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga “FSHU” sh.a.

Shoqëria “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 4646 prot., datë 2.9.2025, protokolluar në ERE me nr. 2396 prot., datë 3.9.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin gusht 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin gusht 2025, “FSHU” sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, “FSHU” sh.a. ka përlogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin gusht 2025 në vlerën 10.92 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 10.92 lekë/kwh, në përputhje me përlogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin gusht 2025: **10.92 lekë/kwh;**

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kwh;**

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”: **1.55 lekë/kwh;**

- Kostot administrative: **1.06 lekë/kwh;**

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **31.7.2025–29.8.2025.**

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së



Fundit për muajin gusht 2025, përlogaritët si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin gusht 2025		
	Njësia	Çmimi
CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	10.92
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.33
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	14.70

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton **14.70 lekë/kwh për muajin gusht 2025.**

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2025, prej **14.70 lekë/kwh** për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 207, datë 9.9.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AMEL ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 2 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2174/9 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Amel Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Amel Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2174 prot., datë 28.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 182, datë 7.8.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.8.2025 dhe 9.8.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.8.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në dy gazeta zyrtare, në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe në rrjetet sociale të institucionit.



- Me shkresën nr. 2174/3 prot., datë 11.8.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- ERE, gjithashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2174/4 prot., datë 11.8.2025, ku po ashtu i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2174/5 prot., datë 22.8.2025 dhe 2174/6 prot., datë 27.8.2025, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është vlerësuar se shoqëria duhet të japë informacion shtesë, në lidhje me vlerën e investimit, ndaj ERE iu drejtua asaj me *email*-in e datës 2.9.2025, protokolluar me nr. 2174/7 prot., datë 2.9.2025.

- Me *email*-in e datës 2.9.2025, protokolluar në ERE me nr. 2174/8 prot., shoqëria ka paraqitur sqarimet përkatëse.

- Sipas analizimit të këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 2428 rep., nr. 1573 kol., datë 28.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Amel Energy’ sh.p.k.”.

- Me shkresën e “OSSH” sh.a., nr. 5721/3 prot., datë 28.6.2022, është miratuar pika e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes.

- Shoqëria është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 2.5.2024, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 2 mw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare të performancës për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 2.5.2026, dhe duhet të fillojë punimet brenda këtij afati. Por nga ana tjetër ajo ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda muajit dhjetor 2025, që është brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së përkatëse. Në këto rrethana, vlerësohet që të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda datës 31.12.2025.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të dokumentacionit sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025.



3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 208, datë 9.9.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GREEN VALUE” SHPK
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-

s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2382/1 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Value’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Green Value” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2382 prot., datë 29.8.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a” dhe “c” dhe pikën 2.5.

- Shoqëria për këtë aplikim duhet të plotësojë dhe sa vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal.

- Duke qenë se shoqëria ka aplikuar paralelisht dhe për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, vlerësohet të saktësohet disponimi i mjeteve financiare për ushtrimin e të dyja veprimtarive (germa “b”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Green Value” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Green Value” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të



ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 209, datë 9.9.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GREEN VALUE” SHPK,
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2381/1 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Value’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Green Value” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2381 prot., datë 29.8.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016,

të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germa “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “a” dhe “c” dhe për pikën 2.4, germën “a”, “b” dhe “d”.

- Shoqëria për këtë aplikim duhet të plotësojë dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Duke qenë se shoqëria ka aplikuar paralelisht dhe për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, vlerësohet të saktësohet disponimi i mjeteve financiare për ushtrimin e të dyja veprimtarive (germa “b”).

Pika 2.4, “Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike”

- Dokumentacion vërtetues mbi mënyrën e parashikuar për disponimin e zyrave nga shoqëria për pjesën e mbetur të periudhës së licencimit (germa “c”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Green Value” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Green Value” sh.p.k. dhe për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 210, datë 9.9.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “NRG POWER” SHPK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika 4 dhe 5, dhe nenit 10, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2315/3 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘NRG Power’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “NRG Power” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria me shkresën nr. 2315 prot., datë 12.8.2025, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për miratim për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “NRG Power” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike nga me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 13.7.2022, i ndryshuar dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.8.2022.

- ERE me shkresën nr. 2315/1 prot., datë 18.8.2025, i ka kërkuar shoqërisë të përcjellë dokumentacionin/informacionin e pa plotësuar në këtë aplikim. Shkresë e cila u kthye nga shërbimi postar, ndaj ERE njoftoi shoqërinë mbi dokumentacionin e munguar nëpërmjet *email*-it zyrtar të datës 25.8.2025 dhe i solli në vëmendje se në referencë të përcaktimeve të kushteve të licencës, duhet të bëjë me dije një adresë të vlefshme për të zhvilluar komunikimin shkresor.

- Shoqëria me shkresën nr. 2315/2 prot., datë 25.8.2025, depozitoi sa kërkuar, duke plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “NRG Power” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë dhe/ose përfaqësuesit ligjor të autorizuar me prokurë.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria ka bërë me dije se kërkon të mos jenë të hapura për publikim “Kontrata e shitjes së kuotave” dhe “Marrëveshja e ortakëve”, pasi konsiderohen se përmbajnë informacion konfidencial, të dhëna që lidhen me kushtet financiare të shoqërisë dhe ortakëve. Në këtë kuadër, të dhënat që lidhen me kushtet financiare, termat tregtarë dhe detyrimet kontraktuale të palëve vlerësohen të mbrohen për të mos cenuar interesat tregtare të shoqërisë dhe ortakëve.

**5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7**

- Pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë.

- Pika 2 – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:

- Janë plotësuar të dhënat e kërkuara mbi identitetin e të licencuarit dhe adresën e tij, në përputhje me gërmat “a” dhe “b”, duke përfshirë emrin e plotë të të licencuarit dhe adresën e saktë të regjistruar.

- Është dhënë informacion mbi arsyet e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm të transferimit dhe ndikimin e tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, si dhe mbi kandidatin e propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe kontributin financiar që ky kandidat do të japë në ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me gërmat “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Pika 3 – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB nga ku të reflektohet ndryshim/transferim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakëve që kontrollojnë interesat e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k.

2. Ortakët e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. bëhen shoqëria “Sustainable Energy Solutions S.M.S.A (SENS)” me 50% të kuotave të kapitalit dhe “Depa Commercial S.A. (DEPA)” me 50% të kuotave të kapitalit.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto palë.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 3.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM
Nr. 211, datë 9.9.2025****MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 160, DATË
18.7.2025, “MBI PEZULLIMIN E
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
‘IDI 2005’ SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10, të rregullores “Për



procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1849/11 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 160, datë 18.7.2025, “Mbi pezullimin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 160, datë 18.7.2025, vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 8.8 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, deri në një njoftim të dytë nga vetë shoqëria, duke i lënë detyrë asaj që brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve të depozitojë në ERE kontratën e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës me nr. 1849/8 prot., datë 23.7.2025, dhe me *email*-in e datës 25.8.2025, i është kujtuar detyrimi i sipërcituar.

- Me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 1849/10 prot., datë 29.8.2025 shoqëria ka njoftuar vështirësinë për nënshkrimin e kontratës dhe ka kërkuar pezullimin e procedurës së licencimit për një afat të pacaktuar, duke u angazhuar të depozitojë kontratën sapo ta nënshkruajë.

Pezullimi i afatit të vendimarrjes

- Referuar nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kur shqyrtimi i një çështjeje administrative varet nga një çështje tjetër ligjore e pavarur (“çështje paraprake”), për të cilën është kompetente një gjykatë ose organ tjetër, organi administrativ ka të drejtë të pezullojë procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë dhe njofton palët për pezullimin.

- Gjithashtu, në nenin 14, pika 10, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë, rast pas rasti, pezullimin e vendimarrjes pas fillimit të procedurës.

- Ndërsa në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet shfuqizohet apo ndryshohet kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin.

- Për sa më sipër, referuar kërkesës së shoqërisë dhe parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, duke qenë se kontrata e nënshkruar me MIE-n është dokument thelbësor për këtë procedurë, vlerësohet të pranohet kërkesa e saj dhe të pezullohet vendimarrja e Bordit të ERE-s për licencimin, deri në depozitimin e kontratës së nënshkruar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 160, datë 18.7.2025, ndryshon dhe bëhet:

“2. Ky vendim është objekt rishikimi me depozitimin nga ana e shoqërisë të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 212, datë 9.9.2025

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 148, DATË
8.7.2025, “MBI PEZULLIMIN E
VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS
SË SHOQËRISË ‘SUNPRO’ SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1848/18 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 8.7.2025, “Mbi pezullimin e vendimarrjes së bordit të ERE lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘SunPro’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 148, datë 8.7.2025, vendosi: “Të pezullojë afatin e vendimarrjes për kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë”, duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda datës 30.9.2025.

- Ky vendim u mor në rrethanat që shoqëria nuk ishte pajisur ende me miratimin përfundimtar, pra marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., për pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1648/16 prot., datë 15.7.2025.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648 prot., datë 28.8.2025, shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën e paraqitur në OST sh.a. në datën

12.8.2025 për marrjen e ofertës së lidhjes së parkut eolik me kapacitet 3 mw me rrjetin e transmetimit, duke konsideruar se me këtë dokument ka përmbushur dhe angazhimin e saj për plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s.

- Nga sa shqyrtuar, rezulton se është depozituar vetëm kërkesa/aplikimi drejtuar OST sh.a., ndërkohë që referuar përcaktimeve të nenit 9, pika 2, germa c, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, duhet të depozitohet miratimi i operatorit të rrjetit, e në rastin konkret nga OST sh.a.

Zgjatja e afatit të vendimarrjes

- Referuar përcaktimeve të pikave 2.2.3 dhe 2.2.4 të “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, afati maksimal brenda të cilit OST sh.a. duhet të kthejë përgjigje në lidhje me pranimin ose refuzimin e një aplikimi është 90 (nëntëdhjetë) ditë.

- Duke qenë se shoqëria ka paraqitur aplikimin e saj në datën 12.8.2025, afati maksimal për të marrë një përgjigje nga OST sh.a., duke përfshirë dhe plotësimin e ndonjë dokumenti të mundshëm të munguar të aplikimit, është data 12.11.2025.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet shfuqizohet apo ndryshohet kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin.

- Për sa më sipër, në rrethanat kur nuk është depozituar ende miratimi i operatorit të rrjetit, sikurse kërkuar nga rregullorja e licencimit, vazhdon të mbetet në fuqi pezullimi i procedurës, por vlerësohet ndryshimi i pikës 2, për sa i përket afatit brenda të cilit shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar, duke i lënë detyrë asaj që brenda datës 22.11.2025, të depozitojë në ERE përgjigjen e OST sh.a. për aplikimin e bërë, duke vlerësuar një kohë prej 10 ditësh për depozitimin e kësaj përgjigjeje, pas afatit maksimal brenda të cilit duhet të shprehet OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE nr. 148, datë 8.7.2025, ndryshon dhe bëhet:

“2. *“Brenda datës 22.11.2025, shoqëria dubet të depozitojë në ERE përgjigjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. për aplikimin e bërë për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.”.*

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SunPro” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 214, datë 18.9.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “NIKOLICA SKI RESORT”
SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,

datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2427/1 prot., datë 15.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nikolica Ski Resort’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Nikolica Ski Resort” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2427 prot., datë 9.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germës “a”.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “a”, “b”, dhe “e”. Ndërsa germat “d” dhe “f” nuk aplikohen për central eolik.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria është pajisur me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 215, datë 13.4.2023, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria “Nikolica Ski Resort” sh.p.k.”.

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr.



1095 rep., nr. 606 kol., datë 14.2.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike eolik, me kapacitet prodhues 3 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria ‘Nikolica Ski Resort’ sh.p.k.”, nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k.

- Shoqëria ka marrë miratimin në parim për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës së OST sh.a., të datës 6.6.2022

- Shoqëria është pajisur me vendimin për VNM-në paraprake, lëshuar më 22.8.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike, me kapacitet të instaluar 3 mw, dhe veprave ndihmëse në zonën e Tragjasit, Vlorë”.

- Në këtë aplikim shoqëria duhet të plotësojë/depozitojë dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Dëshminë e penalitetit të përditësuar, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin e shoqërisë (germa “b”).

- Shoqëria duhet të depozitojë informacion/dokumentacion mbi stafin aktual efektiv në strukturën e saj (germa “c”).

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Dokument të përditësuar mbi gjendjen bankare të shoqërisë dhe vendimin e organeve drejtuese për dedikimin e shumës përkatëse nga fondet e veta për financimin e projektit (germa “b”).

Plan biznesi të përditësuar ku të ketë parashikime për kostot dhe të ardhurat për të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës (germa “c”).

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Informacion/dokumentacion në rast se shoqëria ka vijuar me krijimin e një shoqërie për

qëllime të veçanta, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 215, datë 13.4.2023 (germa “b”).

- Miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes ose marrëveshjen përkatëse të nënshkruar me OST sh.a., nëse shoqëria është pajisur me të, ose përgjigjen e OST sh.a. lidhur me kërkesën e bërë për lidhjen me rrjetin e transmetimit (germa “c”).

- Vlerësohet e nevojshme që të njoftohet AAC-ja për fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë për një afat 30-vjeçar dhe të vihet në dijeni shoqëria në këtë shkresë, kjo në referencë të një korrespondence të zhvilluar më herët me Autoritetin e Aviacionit Civil, ku është kërkuar që në rastet kur një shoqëri aplikon për t’u pajisur në ERE me një licencë për kryerjen e këtij aktiviteti, të vihet në dijeni dhe Autoriteti i Aviacionit Civil, në mënyrë që të identifikohen në një hartë zonat ku do të vendosen objekte të tilla, për t’u ardhur në ndihmë operatorëve të ndryshëm gjatë aktiviteteve të ndryshme të lundrimit ajror.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Aviacionit Civil për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 215, datë 18.9.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SPITALLA SOLAR” SHPK
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2403/4 prot., datë 15.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Spitalla Solar’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Spitalla Solar” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2403 prot., datë 4.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës.

- Shoqëria e ka paraqitur kërkesën e saj për kapacitetin e instaluar 100 mw, por duke qenë se nga dokumentacioni bashkëlidhur këtij aplikimi (marrëveshja e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë) kapaciteti i instaluar është 100 mwp, vlerësohet që kjo të sqarohet në vijim me shoqërinë.

- Pas shqyrtimit paraprak të aplikimit dhe verifikimit financiar në ERE, u vu re se shoqëria nuk kishte kryer pagesën; ndaj, me *email*-in nr. 2403/1 prot., datë 8.8.2025, iu njoftua detyrimi për pagesën. Më 9.9.2025, me *email*-in nr. 2403/2 prot., shoqëria dorëzoi vërtetimin e pagesës dhe vijoi shqyrtimi i

aplikimit, ndërsa më 15.9.2025, me *email*-in nr. 2403/3 prot., dorëzoi dokumentacionin shtesë. Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezultoi se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a” dhe “d”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “a” dhe “b”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka depozituar “Marrëveshjen për zhvillimin e projektit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaiik me vendndodhje në Spitallë, Durrës, Shqipëri”, datë 31.5.2021, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe “Volitalia SA”.

- Shoqëria ka depozituar akt marrëveshjen e datës 20.12.2024, “Marrëveshje përfundimtare në lidhje me marrëveshjen për zhvillimin e projektit për ndërtimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një impianti fotovoltaiik me vendndodhje në zonën e Spitallës, Durrës, Shqipëri”, e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërisë “Volitalia SA” dhe shoqërisë “Spitalla Solar” sh.p.k.

- Shoqëria ka depozituar shkresën e “OST” sh.a., të datës 17.6.2025, për miratimin në parim të pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.

- Në këtë aplikim, shoqëria duhet të plotësojë/depozitojë dhe sa vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim



Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- Vërtetimet e gjendjes gjyqësore për administratorët e shoqërisë, të lëshuara nga autoritetet përkatëse të vendit të tyre të rezidencës, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të apostiluara (germa “b”).

- Informacion/dokumentacion për përbërjen aktuale të stafit teknik të “Spitalla Solar” sh.p.k., të përcaktuar në strukturën organizative të depozituar (germa “c”).

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Shoqëria duhet të bëjë sqarimet përkatëse, në lidhje me vlerën totale të projektit për sa përcaktuar në planin e saj të biznesit, të dokumentojë mbështetjen financiare për pjesën e mbetur të vlerës së projektit dhe të depozitojë letrën e bankës në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin (germat “b” dhe “c”).

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- Miratimin përfundimtar ose marrëveshjen për pikën e lidhjes, të nënshkruar me “OST” sh.a. (germa “c”). ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka deklaruar se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 30 vite, ashtu sikurse nga plani i biznesit rezulton se jetëgjatësia ekonomike është 30 vite, ndaj në rast licencimi, afati i licencës do të jetë për 30 vjet.

- Vendimin për VNM-n paraprake (germa “e”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Spitalla Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 216, datë 18.9.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “DIEZELA” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2358/3 prot., datë 15.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘DIEZELA’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga



ERE për ndryshimin e ortakëve që kontrollojnë interesat e saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “DIEZELA” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën nr. 2358 prot., datë 26.8.2025, ka depozituar kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e të licencuarit, specifikisht nga z. K. M. (me 100% të kapitalit) tek z. L. M. (55% të kapitalit), i cili bëhet ortak kryesor i saj dhe z. C. Q. (45% të kapitalit).

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, i ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE me shkresën nr. 2358/1 prot., datë 4.9.2025 i ka kërkuar shoqërisë të përcjellë dokumentacionin /informacionin e paplotësuar për këtë aplikim.

- Shoqëria me shkresën nr. 2358/2 prot., datë 8.9.2025, depozitoi sa kërkuar, duke plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “DIEZELA” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- neni 5, pika 5 – shoqëria nuk kërkon që ndonjë dokument të konsiderohet konfidencial në këtë aplikim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë;

- pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- gerrat “a” dhe “b” – janë plotësuar të dhënat e kërkuara mbi identitetin e të licencuarit dhe adresën e tij;

- gerrat “c”, “d”, “e” dhe “f” – është dhënë informacion mbi arsyet e ndryshimit të ortakut, efektin e pritshëm pas këtij miratimi, përshkrimi i kandidatit që kontrollon interesat dhe kontributit të tij financiar;

- pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Shoqëria ka përcjellë njoftimin e bërë në MIE (shkresën nr. 03/2025 prot., datë 17.4.2025), nëpërmjet të cilës ka njoftuar këtë të fundit, në lidhje me kalimin e pronësisë mbi kuotën nga ortakut i vetëm z. K. M., tek z. L. M. dhe z. C. Q. Gjithashtu, në këtë shkresë bëhet me dije se kalimi i pronësisë së kuotës, përfshin transferimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që shoqëria ka ndaj palëve të treta, përfshi dhe detyrimet e të drejtat që parashikohen në kontratën e lidhur me MIE-n. Gjithsesi, ERE do të njoftojë MIE-n për dhënien e këtij autorizimi dhe vlerësohet që ky vendim të jetë objekt rishikimi nëse nga ana e MIE-s depozitohet ndonjë qëndrim, në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata nr. 15 rep., nr. 8 kol., datë 10.1.2018.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/



miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakëve, nga z. K. M. (me 100% të kuotave të kapitalit) tek z. L. M. (me 55% të kuotave të kapitalit) dhe Z. C Q (me 45% të kuotave të kapitalit) për shoqërinë “DIEZELA” sh.p.k. (sipas kontratës për shitjen e kuotës datë 26.3.2025).

2. Ortakët e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. ndryshojnë dhe bëhen z. L. M. dhe z. C. Q., ku z. L. M. bëhet ortak kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. (me 55% të kuotave).

3. Shoqëria të depozitojë në ERE qëndrimin/miratimin e MIE-s, menjëherë pas disponimit të kësaj të fundit.

4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikave 3 dhe 4, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe, në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar datë 10.1.2018 apo çdo akt tjetër i ndryshuar që i ka shërbyer kësaj vendimmarrjeje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 255, datë 15.10.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KARIKIMIN E MAKINAVE ELEKTRIKE NË PIKAT/STACIONET E KARIKIMIT ME FUQI TË INSTALUAR MBI 11 kw

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; të “Metodologjisë për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 189, datë 23.11.2017; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “c” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.10.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve me nr. 2586/1 prot., datë 10.10.2025, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 5199 prot., datë 3.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2586 prot., datë 6.10.2025, ka depozituar kërkesën “Për rivlerësimin e të ardhurave dhe miratimin e çmimit të diferencuar të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike”.

- FSHU sh.a. bën me dije se struktura e konsumit të energjisë gjatë periudhës 8-mujore të vitit 2025, ka pësuar ndryshime të rëndësishme në drejtim të rritjes së energjisë së konsumuar për karikimin e makinave elektrike, përdorimi i të cilave po rritet me shpejtësi, duke sjellë nevojën e krijimit të një kategorie të re konsumatore, nisur dhe nga fakti se numri i makinave të regjistruara sipas publikimeve



zyrtare të DPSHRT-së vijon të ketë një rritje të shpejtë nga viti në vit dhe pritet të jetë i tillë edhe për periudhat në vazhdim.

- Nga analiza e të ardhurave dhe e shpenzimeve të realizuara për periudhën janar–gusht 2025, konstatohet se shoqëria ka ruajtur një performancë financiare pozitive, ndërkohë që kostoja e disbalancave ka rezultuar dukshëm më e lartë se niveli i parashikuar në planifikimin fillestar.

- FSHU sh.a. argumenton se tejkalimi i kostove të disbalancave lidhet kryesisht me **shtimin e konsumit nga pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike** të cilat kanë një fuqi të instaluar mbi 11 kw dhe me **pamundësinë për parashikim të saktë** të profileve të karikimit (intensiteti i lartë në fillim të karikimit, variabilitet kohor, përdorim paralel i më shumë se një automjeti etj.).

- Numri i automjeteve elektrike të regjistruara deri në **maj 2025** ka reflektuar **rritje afërsisht 26%** në 5-mujorin e parë 2025, ndërkohë që **rritja e stacioneve të karikimit** me fuqi të instaluar 11 kw ka sjellë edhe **rritje të konsumit** nga kjo tipologji.

- Në kushtet e mësipërme dhe duke respektuar parimet e **kosto-reflektimit, transparencës dhe jodiskriminimit**, vlerësohet se **shtesa mesatare** e kostos së disbalancave që i atribuohet kësaj kategorie arrin rreth **8 lekë/kwh**, mbi çmimin mesatar ekzistues të shitjes që mbulon kostot e planifikuara (14 lekë/kwh); për rrjedhojë FSHU sh.a., propozon **çmimin 22 lekë/kwh** për energjinë e konsumuar në stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11 kw.

- Nga aspekti teknik, furnizimi i makinave elektrike kryhet nëpërmjet pikave/stacioneve të karikimi, të cilat kanë fuqi të instaluar në bazë të përdorimit pikave/stacioneve. Konsumatorët familjarë apo jofamiljarë, të cilët përdorin tipologji karikuesish *slow charge* (AC) për qëllime të karikimit të një makine elektrike për përdorim vetjak, kërkojnë një shtesë fuqie apo pikë lidhje të re deri në një fuqi prej 11 kw, kjo bazuar edhe në kapacitet aktual të karikimit në AC të makinave elektrike, ndërkohë, për pikat/stacionet të cilat karikojnë pa ndërpreje me *fast charge* (DC) mbi një makinë elektrike njëkohësisht kërkojnë një fuqi të instaluar shumë herë më të madhe.

- **Çmimi i shitjes së energjisë elektrike** për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw nga FSHU sh.a. **do të rikuperojë kostot e disbalancave** që

priten të shkaktohen në vijim nga kjo kategori konsumatorësh, të cilat, sipas deklarimeve dhe analizave të shoqërisë, **janë shkaktuar kryesisht nga rritja e ndjeshme e konsumit të energjisë elektrike në pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11 kw.**

- Kjo kategori konsumatori përbën një **segment të ri në tregun e energjisë**, ka sjellë **vështirësi të theksuara në parashikimin e sasisë së energjisë dhe profileve të karikimit**, për shkak të ndryshueshmërisë së kohës së karikimit, intensitetit të lartë të ngarkesës në fazat fillestare të karikimit, si dhe përdorimit paralel të karikuesve me fuqi të lartë në njësi të shumta.

- Në këtë kuptim, **çmimi i shitjes së energjisë elektrike do të reflektojë parimin e kostos reale të shërbimit**, që krijohet nga kjo kategori konsumatore, në përputhje me **parimet e transparencës, jodiskriminimit dhe kosto-reflektimit** të përcaktuara në “Metodologjinë për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”.

- **Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në stacionet e karikimit është propozuar të aplikohet vetëm për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me fuqi të instaluar mbi 11 kw, të cilët shfrytëzojnë kapacitetin e lejuar për karikimin e mjeteve elektrike në pika ose stacione karikimi.**

- Ndërkohë, **abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kw, të cilët përdorin pajisje karikimi me teknologji *slow charge* (AC) për nevoja vetjake, vijojnë të tarifohen me çmimet aktuale të shitjes** sipas kategorisë së konsumatorit.

- Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjinë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë, që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal FSHU”, çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët, sipas nivelit të tensionit ku janë lidhur, duhet të reflektojnë plotësisht kostot që ata shkaktojnë për marrjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, të jenë transparente dhe jodiskriminuese. Qartësisht, kjo metodologji parashikon se të ardhurat e kërkuara (RR) të Furnizuesit Universal do të përbëhen ndër të tjera edhe nga: kostot e lidhura me disbalancat



përkatëse, si dhe çdo lloj kostoje tjetër që ka të bëjë me sigurimin e energjisë elektrike dhe kapacitetit që kërkohet (neni 6, pika 1, germa “a”). Po ashtu, të ardhurat e kërkuara për çdo kategori klientësh do të krahasohen me të ardhurat e pritshme, bazuar në nivelin aktual të çmimeve për çdo kategori klientësh. Tepriat apo mungesat do të identifikohen për secilën nga kategoritë (neni 8).

- Në këtë kuptim, kërkesa e FSHU sh.a. nuk përmban elementet e një aplikimi për përcaktimin apo rishikimin në tërësi të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë, për konsumatorët që shërbehen në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, por evidenton nevojën për kategorizimin e një grupi të ri konsumator dhe rivlerësimin e kostove të shitjes së energjisë elektrike për këtë kategori, përmes të cilit të ardhurat që do të krijohen do të shërbejnë për mbulimin e kostove të shkaktuara nga kjo kategori në periudhën në vazhdim.

- Në zbatim të sa më sipër, ERE në fillim të vitit 2025, kreu analizat dhe vlerësimet e saj mbi nivelin e të ardhurave të kërkuara dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, mbi të cilat u mbështet dhe vendimi i Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.1.2025.

- FSHU sh.a. duhet t'i përmbahet realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda parashikimeve të komponentëve të të ardhurave të kërkuara të vitit 2025, mbi të cilat është mbështetur dhe vendimi i Bordit të ERE-s në fuqi.

- Ndër të tjera, për vlerësimin e sa më sipër janë marrë në konsideratë edhe studimet e IEA (2024), ENTSO-E (2021, 2023) dhe NREL (2020), për rikategorizimin sipas fuqisë së instaluar prej 11 kw.

- Në përfundim, të gjitha burimet e marra në konsideratë arrijnë në përfundimin se rrjeti elektrik po bëhet më kompleks me shtimin e burimeve të rinovueshme dhe stacioneve të karikimit, zhvillime të cilat kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe inovative për balancim.

- Nisur nga të dhëna e analizuar, kosto mesatare mujore e disbalancave mbi plan dhe konsumit mesatar mujor të pikave/stacioneve të karikimit të makinave elektrike arrin në 8 lekë/kwh. Duke marrë në konsideratë parimet mbi të cilat kryhet përcaktimi i çmimeve, si: kosto-reflektuese, transparente dhe jodiskriminuese, vlerësojmë se kjo kosto duhet të shtohet mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike

për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV, meqenëse kostoja e disbalancave e planifikuar mbështetur në vlerat e lejuara nga ERE mbulohen nga çmimi 14 lekë/kwh.

- Çmimi prej 22 lekësh/kwh do të aplikohet nga data 1 nëntor 2025 për të gjithë abonentët familjarë dhe jofamiljarë, të cilët për qëllime të karikimit të një makine elektrike për përdorim vetjak kërkojnë një shtesë fuqie, apo pikë lidhjeje të re me kapacitet të instaluar mbi 11 kw që mund të shfrytëzojnë kapacitetin e lejuar për karikim mjetes elektrike. Ndërkohë që për abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kw, FSHU sh.a. kërkon të vijojë aplikimi i çmimeve respektive të miratuara nga ERE.

- Sikurse aplikohet në kategoritë e tjera konsumatorë, çmimi i shitjes së energjisë aktive në pik do të jetë 15% më i lartë se çmimi i shitjes së energjisë aktive që i korrespondon kësaj kategorie.

- **Çmimi i shitjes së energjisë elektrike** për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw do të aplikohet nga data **1 nëntor 2025**.

- Sa i takon energjisë elektrike, e cila konsumohet në pik nga kjo kategori, sikurse aplikohet në kategoritë e tjera konsumatore, çmimi i shitjes së energjisë aktive në pik do të jetë 15% më i lartë se çmimi i shitjes së energjisë aktive.

- Duke qenë se të dhënat mbi të cilat është kryer ky vlerësim janë paraprake, ERE, në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a., sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (ose në varësi të rrethanave edhe me iniciativën e saj), në rast të konstatimit të ndryshimeve të komponentëve përllëgaritës të të ardhurave të kërkuara, do të kryejë korrigjimet përkatëse në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë, që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw të lidhura në nivelin e tensionit 04 kV, që do



të aplikohet nga 1 nëntor 2025, sipas tabelës bashkëlidhur.

Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive lekë/kWh	*Çmimi i energjisë aktive në pik lekë/kWh
Pika/stacione karikimi të makinave elektrike me fuqi të intaluar mbi 11kW	22	25.3
Orari në pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është:		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars ora 18:00 - 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor ora 19:00 - 23:00		

2. Të ardhurat e realizuara mbi/nën ato të lejuara do të korrigjohen nga ERE, në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017, në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a. dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë FSHU sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 238/17, datë 13.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Ndërtim rruga ‘Kthesa e Bërdicës–Ura e Baçallëkut’”, sipas tekstit dhe tabelës paraprake bashkëlidhur kësaj shkrese.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Vlerësimi për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa vlerësimi për pasuritë e llojit “ndërtesë social-ekonomike”, është bërë në zbatim të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, publik”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit: 57 519 770.70 (pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “NDËRTIM RRUGA ‘KTHESA E BËRDICËS–URA E BAÇALLËKUT”

Nr. rendo r	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Të dhënat për shpronësim														Shënime	
								Arë			Truall			Pemëtore			Social-ekonomike		Ndërtesë banimi				Vlera totale (lekë)
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Numri i pasurisë	Lloji	Sip. totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësu ar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja e shpronësu ar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja e shpronësu ar (m²)	Vlera sipas preventivit (lekë)	Sipërfaqja e shpronësu ar (m²)	Çmimi (m²)	Vlera (lekë)		
1	Sokol Aida		Dibra Dibra	8591	18/120	Truall	2,330.0 0				52.5	8,511.00	446,827.50									446,827.50	Pasuria nr. 1/120 u hipotekua në favor të Bankës së Tiranës sh.a. datë 12.12.2005, sipas kontratës së hipotekimit nr. 2186/994, me datë 16.6.2006 u riblokua në favor të Bankës së Tiranës sh.a. në bazë të kontratës nr. 1529 rep., 830 kol., datë 15.6.2006, me datë 11.12.2012 lirohet pasuria me deklarimet noteriale nr. 2838/2068.
2	Adilje Danish Ismet Dashami r Shkëlq im Meme Tomorr Shpetim Admir Sedat Petrit Rudina	Ibrahim Faik Faik Faik Salih Sabri Ibrahim Ferid Ferid	Daca Daca Tuzi Tuzi Tuzi Daca Daca Daca Daca Daca Mushani(Dac a)	8591	18/1	Truall	5,100.00				2535	8,511.00	21,575,385.00									21,575,385.00	Mbi këtë truall ndodhet pasuria 18/48, vol. 10, f. 44, pasuria është e regjistruar shtet, lloji i pasurisë kanal, në pjesën përfundimtare i veçantë të kartelës shërbet – sipas ref. 08956, lloji i pasurisë nga kanal nën ndërtesë, (tubacion i betonuar i ujërave të zeza).
3	Vehbi		Kraja	8591	18/11	Truall	1,815.00				76.2	8,511.00	648,538.20									648,538.20	
4	Skender Ruzhdi Rauf Eqerem Hilmi Can Jup Muhamet Servete Lirije Sathere Arjet Arben		Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha Bilani Bilani Bisha Bisha Bilani Bilani Bilani	8591	17/1271	Truall	5,956.0 0				146.2	8,511.00	1,244,308.20									1,244,308.20	
5	Tedfik Ismail Kimeta Ejup Esat Hava Daut Rifat Hajrudin h Halit Ermina Bardhyl Sather Shfqet Halit Hysen Bajram Milinat Nazmi Yllf Durrige Ali Zija Sinajip	Jonuz Jonuz Jonuz Jonuz Qazim Qazim Qazim Qazim Qazim Jula Jula Halit Jula Halit Jula Osman Osman Osman Osman Osman Osman Osman Qazim Demi Qazim Demi Qazim Demi	Malevija Malevija Malevija Malevija Malevija Malevija Malevija Malevija Malevija Malevija Jula Jula Halit Jula Osman Osman Osman Osman Osman Osman Osman Qazim Demi Qazim Demi Qazim Demi	8591	17/473	Truall	450.00				156	8,511.00	1,327,716.00									1,327,716.00	
6	Xhelal	Met	Milla	8591	17/846	Truall	1,726.00				141	8,511.00	1,200,051.00									1,200,051.00	Pasuria hipotekohet në favor të Alpha Bank datë 6.4.2007, me kontratë hipotekimi datë 5.4.2007, ref. 010466, përmban deklarimet noteriale 283/134/1, lejë legalizimi nr. 284 gen plan KPP, ortofoto digitale, planimetria e katit përdhe, libri i parcelave ndërraport, certifikatë pronësie.



7	Oseman	Dan	Nasufi	8591	17/845	Truall	1,000.00				106.8	8,511.00	908,974.80						908,974.80	Lëshohet certifikatë sipas ref. 015868, datë 26.11.2014, goditëse banimi 3-katëshe social-ekonomike, kati përdehe 166.2 m², kati i parë 240.9 m² banim, kati i dytë 223.7 m².
8	Besemir	Agim	Parasporja	8591	17/616	Pemëtores	3000						-	88.4	270.00	23,868.00			23,868.00	Ndërrshoi lloji i pasurisë nga truall në pemëtores sipas urdhrit datë 17.3.2005, ref. 07049.
9	Kanto	Filip	Corri	8591	17/456	Truall	1,500.00				98.5	8,511.00	838,333.50						838,333.50	Kontratë shitjeje datë 6.9.2020.
10	Përpari m Fatjola	Ali Nazim	Muçejani Muçejani	8591	17/457	Truall	2,000.00				61	8,511.00	519,171.00						519,171.00	Kontratë qiraje nr. 2047/1517, datë 25.7.2019 mes palëve Përpari Mucejani, në cilësimin e qiradhnësist dhe subjektit "JUNIT" me administrator Tonin Koliqi në cilësimin e qiramarësist, kohëzgjatja e kontratës është 10 vjet. Objekti i kësaj kontrate është një sipërfaqe përpara truallit prej 2000 m² dhe objekti ngrihet mbi të i cili është në proces legalizimi.
11	Shefki	Abdyt	Duli	8591	17/602	Truall	3,000.00				49	8,511.00	417,039.00						417,039.00	Më datë 31.1.2022 u krye rivlerësimi i pasurisë, rivlerësimi është i vlefshëm deri në një transaksion tjetër.
12	Suzane Immedin Amedina	Ilir Ilir	Faslija Faslija	8591	17/601	Truall	2,000.00				57.7	8,511.00	491,084.70						491,084.70	
13	Gjovalin	Vlash	Luca	1159	80/17	Arë+truall	352.00	57	270	15,390.00									15,390.00	
14	Bashkim	Selim	Meti	1159	16/41	Arë	2,500.00	87.5	270	23,625.00									23,625.00	
15	Serjan	Shyqyri	Meti	1159	16/45	Arë	3,500.00	163.4	270	44,118.00									44,118.00	
16	Shkelqim	Hasan	Kuburja	1159	16/60	Arë	1,000.00	70	270	18,900.00									18,900.00	
17	Besnik	Hasan	Kuburja	1159	16/61	Arë	1,000.00	60	270	16,200.00									16,200.00	
18	Gjon Ndue	Zef Zef	Treshaj Treshaj	1159	16/62	Truall	1,000.00				52.4	321.00	16,820.40						16,820.40	
19	Blodar	Çelë	Smakaj	1159	16/70	Arë	1,506.00	186.6	270	50,382.00									50,382.00	
20	Shkelqim Suzanë	Adem Shernsi	Dini Dini	1159	16/106	Arë	500.00	54.6	270	14,742.00									14,742.00	Mbi këtë pasuri pozicionohet pasuria nr. 16/104ND, vol. 7, f. 46.
21	Defrim Orjola	Brahim Shyqyri	Alija Alija	1159	16/53	Arë+truall	1,000.00	79.5	270	21,465.00									21,465.00	
22	Halit		Kastrati	1159	16/54	Arë	4,500.00	11.3	270	3,051.00									3,051.00	
23	Nexhip Shkelqim Ermire	Qazim Qazim	Kastrati Kastrati	1159	16/10	Arë	5,250.00	169.5	270	45,765.00									45,765.00	
24	Ardis Ardita	Besnik	Hallunaj Hallunaj	1159	16/9	Arë	2,000.00	59.70	270	16,119.00									16,119.00	
25	Idman Lindita	Cuf Sabri	Halili Halili	8591	17/615/ND	Ndërtesë	82.2							82.20	2,260,771.20				2,260,771.20	
26	Marin Murgjeri a	Albert Zef	Nikaj Nikaj	8591	18/812	Truall	95.00				8.6	8,511.00	73,194.60						73,194.60	
27	Mefia	Rifat	Isufi	1159	16/58	Arë+truall	1,793.60				69.6	321.00	22,341.60						22,341.60	
28	Xhavit	Ali	Brahimi	1159	16/59	Arë+truall	1,252.50				79.1	321.00	25,391.10						25,391.10	
29	Xhihat	Latif	Gusha	8591	17/1443	Truall	713.00				298.6	8,511.00	2,541,384.60						2,541,384.60	Mbi këtë pasuri bën ndërtesa e legalizuar nr. 17/1463 ND, vol. 62, datë 16S.
30	Skender Ruzhdi Rauf Egereç Hilmi Can Jup Muhame i Servete Lirije Sathere Arjet Ahten		Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha Bilani Bilani Bisha Bisha Bilani Bilani Bilani	8591	17/1272	Truall	1,237.00				1166.7	8,511.00	9,929,783.70						9,929,783.70	
31	Dritan Zamir	Qemal Qemal	Kruja Kruja	8591	18/728	Truall	542.00				364	8,511.00	3,098,004.00						3,098,004.00	
32	Edmond Admir	Faik Muhamet	Hardalli Hardalli	8591	17/1257	Truall	235.00				235	8,511.00	2,000,085.00						2,000,085.00	



33	Ramazan		Kraja	8591	17/944	Truali+objekti	128.00				7.6	8,511.00	64,683.60						128.00	58,470.00	7,484,160.00	7,548,843.60	Kjo pasuri hipotekohet në favor të P>SH>M datë 29.1.2008.
34	Idman	Cuf	Halili	8591	17/1406	Pemëtores	8,338.50							303.60	270.00	81,972.00						81,972.00	Pasuria është rihipotekuar në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., datë 6.1.2015. Likuidimi i pasurisë do të bëhet pas saktësimit të dokumentacionit të pronësisë, ku të pasqyrohet përputhshmëria e midis sipërfaqes totale kartelë-hartë.
35	Qamil		Zela	8591	17/615	Pemëtores	164.90						-	37.50	270	10,125.00						10,125.00	
SHUMA PARAPRAKE													47,389,117.50			115,965.00		2,260,771.20			7,484,160.00	57,519,770.70	

**KËRKESË****Nr. 847/10, datë 10.10.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Ndërhyrje në zona sportive dhe lodra për fëmijë, ‘Dua të Luaj’, Bashkia Fier”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të

Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë e Fierit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit: 193,385,534 (njëqind e nëntëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRHYRJE NË ZONA SPORTIVE DHE LODRA PËR FËMIJË, ‘DUA TË LUAJ’”, BASHKIA FIER

Nr.	Pronari	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Truall			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri Atësi Mbiemër	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji	Sip. totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë		
1	AGRON DHORI MITA DHORI GORI MITA	8532	1/513	Truall	1432	1,432.00	12,458	17,839,856.00	17,839,856.00	
2	LILI TAQI SHKURTI	8532	1/512	Truall	1796	1,796.00	12,458	22,374,568.00	22,374,568.00	
3	ERION SOTIR SHKURTI	8532	1/511	Truall	1544	1,544.00	12,458	19,235,152.00	19,235,152.00	
4	ARSINO MARKO BACKA	8532	1/1018	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	Shënim. Seksioni E: vendim gjykatë nr. 365, dt. 2.9.2011, në pronësi të z. Arsino Backa.
5	URANI MITI KULE	8532	1/1017	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
6	TEFTA MITI PRIFTI	8532	1/1016	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
7	MIKAIL MITI PRIFTI	8532	1/1015	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	
8	LEONORA MITI KOÇI	8532	1/1014	Truall	285.6	285.60	12,458	3,558,004.80	3,558,004.80	Shënim. Seksioni E: Seksioni i Pronësive nuk mund të plotësohet pasi pronari është e ndëra me emrin Leonora Miti Koci, përfituar me kontratë pjesëtimi datë certifikate 13.3.2006.
9	DRITA LLAMBI MICI VIKTORI LLAMBI KOÇI DHIMITRAQ LLAMBI SHKURTI ARQILE LLAMBI SHKURTI	8532	1/509	Truall	1560	1,560.00	12,458	19,434,480.00	19,434,480.00	
10	TODI TAQI SHKURTI LLAMBI TAQI SHKURTI ERION SOTIR SHKURTI LILI TAQI SHKURTI URANI MITI KULE LEONORA MITI KOÇI TEFTA MITI BARDHI MIKAIL MITI PRIFTI VASIL MITI PRIFTI AGRON DHORI MITA DHORI GORI MITA	8532	1/591	Truall	891	891.00	12,458	11,100,078.00	11,100,078.00	Shënim. Seksioni E: vjen nga pasuria 1/303, vol. 14, f. 157 në bazë të k. pjesëtimi. Kjo pasuri shfrytëzohet si rrugë
11	NAUNKA TRIFON GOGA ÇELJETA MIKAIL SULO DENISA MIKAIL GOGA	8532	1/1070	Truall	700	700.00	12,458	8,720,600.00	8,720,600.00	Shënim. Seksioni C: nr. regjistrimi 00015675, datë regjistrimi 24.5.2017. Me aplikim nr. 16003, datë 22.6.2017 bëhet RVP në vlerën 8720600 lekë. Ky regjistrim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni.
12	EUGEN KRISTAQ MINO NATASHA GORI MINO KLEMENT GORI MINO KLODETA ILIR DHANAJ	8532	1/1071	Truall	700	700.00	12,458	8,720,600.00	8,720,600.00	Shënim. Seksioni B: kontratë shitjeje nr. 1338 rep., nr. 929 datë 16.4.2025. Regjistruar nr. 00020788, datë 5.5.2025.



13	MARJANTHI NAUN GOGA	8532	1/1066	Truall	4195	4,195.00	12,458	52,261,310.00	52,261,310.00	
14	PANDELI NAUN GOGA	8532	1/1069	Truall	700	700.00	12,458	8,720,600.00	8,720,600.00	
15	SHTET	8532	1/581	Rrugë	7426	2,289.00		-	-	Shënim. Seksioni E: në përdorim të Bashkisë Fier. Vendors pronesia shtet për efekt sistemi por është me CP në emër të Republikës së Shqipërisë
16	MAKSIM NAUN ÇEPELE VITË NAUN RINA KLARIDA ALI GOGA KLEANTINO PIRO GOGA DHIMITRI NAUN GOGA PANDELI NAUN GOGA MARJANTHI NAUN GOGA THOMA NAUN GOGA MIKAIL GOGA NAJE GOGA ATHINA GOGA	8532	1/434	Truall	841	577.00	12,458	7,188,266.00	7,188,266.00	Shënim. Seksioni E: pjesa takuese e bashkëpronarit Mikail Goga 1/11 nuk mund të shrohet në multifunksional pasi rezultoi i ndjerë dhe Naje Liko Goga me pjesë takuese 1/11 rezultoi e ndjerë.
SHUMA TOTALE PARAPRAKE									193,385,534.00	

KËRKESË**Nr. 283/20, datë 10.10.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Zgjerimi i superstradës Tiranë–Durrës (loti 1) – faza I & faza II’”, me vlerë totale 28,282,761.40 (njëzet e tetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë dyzet) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë

private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit: 28,282,761.40 (njëzet e tetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë dyzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE, SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “ZGJERIMI I SUPERSTRADËS TIRANË–DURRËS (LOTI 1) – FAZA 1 & FAZA 2”

Pronari				Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimi për shpronësim							
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë				Tokë “truall “			Ndërtesë social-ekonomike			Vlera Totale (lekë)	Shënime
				ZK	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Sip. totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera sipas preventivit (lekë)		
1	Shoqëria “Alumil- Albania” sh.p.k.			2119	148/20	Truall	12,416.00	2563.8	4,242.00	10,875,639.60				10,875,639.60	Kontratë për vendosjen e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës sipas vlerave të kredisë me vendim nr. 25, datë 19.6.1995, të KRRRT Rrethi Tiranë dhe KRT Republikës është kthyer në truall. Me vendimin nr. 14, datë 18.10.2001, të KRRRT Bashkisë Vorë është ndërtuar objekti “Fabrikë e prodhimit të profileve të duraluminit”.
2	G.P.A.			2119	148/44	Truall	3,400.00	506.3	4,242.00	2,147,724.60	906.00	456.00	7,294,193.80	9,441,918.40	Kontratë për vendosjen e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës sipas vlerave të kredisë.
3	Mirela Ismail Papuli			2119	257/7	Truall	3,203.00	414.4	4,242.00	1,757,884.80				1,757,884.80	Rivlerësohet pasuria në shumën 64.860.750 lekë, aplikimi 172287 datë 29.5.2017, i vlefshëm deri në transaksionin e radhës.
4	Mirela Ismail Papuli			2119	257/10	Truall	3,182.00	776.9	4,242.00	3,295,609.80				3,295,609.80	Në favor të Banka Amerikane e Investimeve sh.a. për shumën 2665000 euro, k. hip. 6278/2596, datë 5.11.2019. pasuria bllokohet në favor të Banka Amerikane e Investimeve për shumën 950000 euro, k. hip. nr. 329 rep., 277 kol., datë 2.5.2018.
5	Shoqëria “Eurobeton 2005” sh.p.k.			2119	257/3	Truall	11,665.00	686.4	4,242.00	2,911,708.80				2,911,708.80	Në favor të Union Bank sh.a. për shumën 500 000 euro, k. hip. nr. 6069/2732, datë 17.12.2015, bllokohet në favor të Union Bank sh.a. për shumën 1 500 000 euro, k. hip. 4707/1575, datë 26.7.2018, noter R. Koçi, impiant prodhimi betoni dhe zyra 1-katëshe plus garbinë elektrike.
SHUMA PARAPRAKE														28,282,761.40	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

